

## **RELACION**

### **PËR PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 328, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektvendim ka si qëllim realizimin e reformës përritjen e pagave, nëpërmjet:

- ndryshimit të vlerave të kufijve të pagave, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, si dhe të nëpunësve civilë, të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- ndryshimit të mënyrës së llogaritjës së shtesës përvjetërsi në punë;
- barazimit të vlerës së kufirit maksimal të pagës së pozicionit për nëpunësit civilë dhe të tjerë të barazuar me ta, me vlerën e pagës së pozicionit të klasës korresponduese të nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi hartohet si pasojë e detyrimit ligjor që ka Këshilli i Ministrave për të bërë përcakte/rrëgullime/ndryshime në vendimet e pagave për institucionet e administratës shtetërore, qendrore apo vendore.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në vijim të procesit për reformën e pagave të nëpunësve/punonjësve të administratës publike dhe rritjen e niveleve të tyre, të parashikuar për vitet 2023 – 2024, bazuar në iniciativën e qeverisë shqiptare për këtë qëllim, për kufijtë e pagave, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, si dhe të nëpunësve civilë, të njësive të vetëqeversijes vendore për vitin 2024, në këtë projektvendim parashikohet:

a) **Rritja e vlerave të pagës për pozicion**, nëpërmjet ndryshimit:

- i) të vlerave të kufijve të pagave, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar;
- ii) vlerave të kufijve të pagave të nëpunësve civilë, duke rritur ndjeshëm nivelet e kufijve minimalë dhe maksimalë;
- iii) të vlerave të kufijve të pagave të administratorëve, të njësive administrative.

Vlen të theksohet se në kuadër të reformës së pagave të dizenjuar gjatë viteve 2023 – 2024, nëpërmjet këtij projektvendimi realizohet barazimi në kufirin maksimal i vlerës së pagës së pozicionit të nëpunësve civilë dhe të tjerë të barazuar në pagë me ta në njësitë e vetëqeversijes vendore, me vlerën që i korrespondon pagës së pozicionit tek klasat përkatëse të pagave të nëpunësve civilë në administratën shtetërore.

b) **Ndryshimi i llogaritjes së elementit “shtesë për vjetërsi në punë”, duke e njesuar me mënyrën e llogaritjes së këtij elementi për nëpunësit/punonjësit e tjerë të institucioneve të administratës publike.**

Shtesa për vjetërsi në punë nga 2% për çdo vit deri në 25 vjet, që aktualisht llogaritet mbi pagën e grupit, nëpërmjet këtij projektvendimi propozohet të jepet deri në 30 vjet dhe të llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

c) **Rishikimi i elementit “shtesë për nivelin e kualifikimit”,** referuar Kornizës shqiptare të Kualifikimeve, sipas përcaktimeve në ligjin 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke e përcaktuar në të njëjtat vlera si edhe për nëpunësit e punonjësit e tjerë të institacioneve të administratës publike, vlera që pasqyrohen në lidhjen nr. 9, që i bashkëlidhet projektaktit, sipas grupeve të diplomave.

ç) **ripërcaktimi i klasës së pagës për funksionarët e kabineteve,** duke vendosur klasën e pagës së duhur në përputhje me ndryshimet e kategorive dhe klasave të përcaktuara sipas këtij projektvendimi:

- i) për pozicionet “sekretar”;
- ii) për funksionarët e kabineteve , “Drejtor kabineti”, “Këshilltar” dhe “Zëdhënës”.

Si rezultat i ndryshimeve të sipërcituara rritjet mesatare variojnë si vijon:

a) për Bashkinë e Tiranës:

a/1) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë me vjetërsi mesatare 15 vite përfitojnë një rritje në masën 23% deri në 65%;

a/2) për vlerat e kufirit maksimal:

- nëpunësit civilë me vjetërsi mesatare 15 vite nga niveli i përgjegjësit të sektorit deri tek niveli i sekretarit të përgjithshëm përfitojnë një rritje vetëm për efekt të ndryshimit të llogaritjes së vjetërsisë në punë në masën 5,1% deri në 7,4%;
- nëpunësit civilë me vjetërsi mesatare 15 vite për pozicionet specialist përfitojnë një rritje për efekt të rritjes së pagës së pozicionit dhe për efekt të ndryshimit të llogaritjes së vjetërsisë në punë në masën 15% deri në 16%.

b) për bashkitë me mbi 200 000 banorë:

b/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët përfitojnë një rritje në masën 70%, ndërsa nënkyetarët në masën 50%;

b/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite përfitojnë një rritje në masën 18% deri në 55,8%;

b/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët përfitojnë një rritje në masën 57%, ndërsa nënkyetarët në masën 41%;

b/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite përfitojnë një rritje në masën 15,6% deri në 60%;

c) për bashkitë me mbi 100 001 – 200 000 banorë:

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeversjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeversjes vendore””.

- c/1) pēr vlerat e kufirit minimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 58%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 70%;
- c/2) pēr vlerat e kufirit minimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 18% deri nē 103%;
- c/3) pēr vlerat e kufirit maksimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 53%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 41%;
- c/4) pēr vlerat e kufirit maksimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 15,6% deri nē 84%;
- d) pēr bashkitē me mbi 50 001 – 100 000 banorē:
- d/1) pēr vlerat e kufirit minimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 128%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 113%;
- d/2) pēr vlerat e kufirit minimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 19% deri nē 103%;
- d/3) pēr vlerat e kufirit maksimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 79.3%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 64%;
- d/4) pēr vlerat e kufirit maksimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 37,5% deri nē 94%;
- e) pēr bashkitē me mbi 20001 - 50000 banorē:
- e/1) pēr vlerat e kufirit minimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 131%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 141%;
- e/2) pēr vlerat e kufirit minimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 19% deri nē 115%;
- e/3) pēr vlerat e kufirit maksimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 92%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 76%;
- e/4) pēr vlerat e kufirit maksimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 52% deri nē 105%;
- f) pēr bashkitē deri nē 20 000 banorē:
- f/1) pēr vlerat e kufirit minimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 185%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 249%;
- f/2) pēr vlerat e kufirit minimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 20% deri nē 123%;
- f/3) pēr vlerat e kufirit maksimal kryetarēt pērfitojnē njē rritje nē masēn 128%, ndērsa nēnkryetarēt nē masēn 95%;
- f/4) pēr vlerat e kufirit maksimal nēpunēsit civilē dhe tē tjera tē barazuar me ta me vjetērsi mesatare 15 vite pērfitojnē njē rritje nē masēn 60% deri nē 128%;

---

Relacion shpjegues pēr projektvendimin “Pēr disa ndryshime nē vendimin nr. 328, datē 31.5.2023, tē Kēshillit tē Ministrave “Pēr klasifikimin e funksioneve, grupimin e njēsive tē vetēqeversjes vendore, pēr efekt page, dhe caktimin e kufijve tē pagave tē funksionarēve tē zgjedhur e tē emēruar, tē nēpunēsve civilē e tē punonjēsve administrativē tē njēsive tē vetēqeversjes vendore””.

g) për keshillat e qarqeve:

g/1) për vlerat e kufirit minimal kryetarët përfitojnë një rritje në masën 86%, ndërsa nën kryetarët në masën 113%;

g/2) për vlerat e kufirit minimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite përfitojnë një rritje në masën 18% deri në 84%;

g/3) për vlerat e kufirit maksimal kryetarët përfitojnë një rritje në masën 53%, ndërsa nën kryetarët në masën 64%;

g/4) për vlerat e kufirit maksimal nëpunësit civilë dhe të tjera të barazuar me ta me vjetërsi mesatare 15 vite përfitojnë një rritje në masën 15.6% deri në 55%.

gj) administratorët e njësive administrative përfitojnë një rritje të kufirit minimal nga 30% - 33% dhe për kifirin maksimal një rritje 29% - 75%.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të:

- Nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”;
- Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Gjithashtu, theksojmë se ky projektvendim nuk përfshihet në kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të pikës 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe të përcaktimeve të vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregulator të KQZ-së, sipas të cilit përcaktohet se ndër veprimtaritë e ndaluara janë:

*“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratuar në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave...”*

Arsyetimi mbi të cilin bazohemi është si vijon:

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore””.

1. Fondi i nevojshëm që nevojitet si pasojë e miratimit të këtij projektvendimi është i miratuar në fondin e kontigjencës, në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin 2023.
2. Nga shqyrtimi dhe analiza që i bëjmë përcaktimit të cituar më sipër, si dhe përcaktimeve të tjera të Kodit Zgjedhor rezulton se në këtë rast ligjvënësi dhe Komisioni Rregullator i KQZ-së ka përdorur vetëm termin “qeverisë së re” (pika 4, e nenit 91, të kodit, si dhe pika 3, e nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator të KQZ-së), duke mos përfshirë përvèç tij edhe termin “organet apo këshillat e qeverisjes vendore” siç përmendet, ky i fundit, edhe nënenet e tjera të Kodit Zgjedhor.
3. Nga shqyrtimi që i bëjmë përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, të ndryshuar, në rastin e njësive të vetëqeverisjes vendore, rezulton se:
  - ✓ Termi i përdorur për organet që drejtojnë këto njësi është “organet e vetëqeverisjes vendore”, ndërsa me termin “qeverisje qendrore”, kuptohet Këshilli i Ministrave.
  - ✓ Këshilli bashkiak dhe këshilli i qarkut quhen “organe përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore”, ndërkohë që organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë, ndërsa në rastin e qarkut, funksionet ekzekutive në të kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut.
  - ✓ Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore (organet përfaqësuese të bashkive) dhe kryetarët e bashkive zgjidhen, dhe më pas këshillat “konstituohen”.
4. Gjithashtu, sjellim në vëmendje që në pikat 1, 2 dhe 3, në raport me pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, ndalimet janë të lidhura me fushatën zgjedhore, pa bërë një dallim ndërmjet zgjedhjeve për Kuvendin ose zgjedhjeve vendore. Nga ana tjetër, në pikën 4, natyra e ndalimit nuk është e shtrirë vetëm gjatë fushatës zgjedhore, por 4 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në formimin e “qeverisë së re”. Natyra e këtyre ndalimeve, është e lidhur ngushtësisht me zgjedhjet për Kuvendin, nëpërmjet të cilave, në përputhje me parashikimet kushtetuese, zgjidhet edhe qeveria e re. Ky lloj ndalimi është në linjë me natyrën e zgjedhjeve për Kuvendin, sa kohë, qeveria dhe Kuvendi janë në fund të mandatit të tyre dhe rrjedhimisht vendosen ndalime në fund të mandatit me qëllim që të shmanget çdo lloj abuzimi i mundshëm nga qeveritë në fund të mandatit, nëpërmjet marrjeve të vendimeve të ndaluara sipas pikës 4, të këtij neni. Kjo lloj praktike është e njohur edhe në vende të tjera ku, në një periudhe të caktuar përpëra përfundimit të mandatit qeverisës, qeverisë i ndalohet marrja e vendimeve me efekte të ndjeshme financiare, përvèç

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, përfundimit të mandatit qeverisës, qeverisë i ndalohet marrja e vendimeve me efekte të ndjeshme financiare, përvèç

atyre që janë të domosdoshme dhe që sjellin administrimin e zakonshëm të punëve të qeverisë.

Në përfundim, arrijmë në konkluzionin se ky ndalim është për rastin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë.

Së fundi, theksojmë se me shkresën nr.130/3, datë 28.1.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka sqaruar që “*Nuk ndalohen veprimtaritë e parashikuara në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor*” (pika 3, e ndarjes I, të shkresës) dhe “*Nuk ndalohen veprimtaritë e parashikuara në nenin 3, pikat 3 dhe 5*”, të vendimit nr. 9, datë 24/12/2020, të Komisionit Rregullator të KQZ-së (pika 3, e ndarjes II, të shkresës).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin e ndonjë acquis të BE-së.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim propozohet nga Zëvendëskryeministri, dhe në përbajtje të tij ka 3 pikat, dhe 9 lidhje që propozojnë:

Pika e parë: propozon ndryshimin:

- e pikave, nr. 3, nr. 5, dhe nr. 6, të vendimit aktualisht në fuqi;
  - zëvendësimin e lidhjeve nga nr. 1 deri në nr. 10, të vendimit nr. 328, datë 31.5.2023, me lidhjet nga nr. 1 deri në nr. 9, që i bashkëlidhen këtij vendimi;
  - ndryshim në pikat nr. 7 dhe nr. 8, të vendimit aktualisht në fuqi.

Pika e dytë: parashikon përballimin e efekteve financiare për vitin 2024, e konkretisht: (i) për nivelet e pagave sipas kufirit minimal, nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vtitit 2024”, të ndryshuar; (ii) për çdo nivel page të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal, nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

**Pika e tretë:** përcakton institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, që janë njësítë e vetëqeverisjes vendore.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore””.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi janë njësitë e vetëqeversijes vendore, pjesë e fushës së veprimit të vendimit nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe në fazën e përgatitjes së tij është konsultuar me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV ka dërguar pranë DAP-it, MF-së dhe Zëvendëskryeministrit, shkressën nr. 4064, datë 19.07.2024 me propozimet përkatëse, të reflektuara në këtë projektvendim).

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet financiare që rrjedhin nga rritja e kufirit minimal të pagës, të cilat do të përballohen nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave të përcaktuara në ligjin 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, sipas llogaritjeve të ministrisë përgjegjëse për financat janë vlerësuar në masën 3.1 miliardë lekë në vit.

### **PROPOZUESI**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**